

17.03.2014 - Agjencia dhe Universiteti i shkencave informatike dhe teknologjike " Shën Apostol Pavle" Ohër nënshkruan memorandum për bashkëpunim.

✘ **SHKUP-17.03.2014** Kryetari i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Dr. Zoran Trajčevski dhe reaktori i Universitetit për shkencë informatike dhe teknologjike " Shën Apostol Pavle" Ohër, Prof. Dr. Ninosllav Marina, nënshkruan memorandum bashkëpunimi, që ka për qëllim zhvillimin dhe përparimin e marrëdhënieve të partnerëve në mes dy institucioneve, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si seminare, konferenca, punëtori, shkëmbimi i informatave relevante të cilat janë me interes të përbashkët, pjesëmarrje e përbashkët në profesione arsimore dhe manifestime të tjera lidhur me forcimin e kapaciteteve dhe kualitetin e shërbimeve të të dy institucioneve.

Theks i veçantë do të vihet mbi aktivitetet e fushëveprimit të Agjencisë:

- përpunim i sasive të mëdha të të dhënave,
- analizë e programeve të radiodifuzerëve gjatë punës së tyre ditore dhe gjatë periudhës së zgjedhjeve,
- ndjekje për respektimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme nga ana e operatorëve të rrjetit të komunikacionit elektronik publik,

Të cilat do të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit të të dy institucioneve nga programa e Horizont 2020 dhe Instrumenti i ndihmës për para-anëtarësim – IPA etj.

